

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skenar lufte/ Lituania teston evakuimin e Vilniusit në rast sulmi, stërvitja më e madhe ushtarake përfshin mijëra zyrtarë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/skenar-lufte-lituania-teston-evakuimin-e-vilniusit-ne-rast-i-stervitja--i588801
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 18:05:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 18:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e8c1c3ddfd8ed20f2d2243d80631d6fc09a1f44c6c041d1932322c6fda563df
TEKSTI	1cf8ee98b35c9623f110ca2aa8a1bd99b957a4a92b6fd56a80e6330c36207400
PAMJA	c42d3a878b56e2563a43b924c9b79b598cd49e7076d01bf6f3ef923147d36d9d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	deb0741712b5abdeaef823f651cb05f97f54c93fdb2a1ba554506a4f3b7dbab
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	b1c7a27947b4cc546e59bf39e541eaf49f294f8d53ee0afce777d7f589624631
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/deb0741712b5abdeaef823f651cb05f97f54c93fdb2a1ba554506a4f3b7dbab>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by



English



1 e [Skenar lufte/ Lituania teston evakuimin e Vilniusit ne rast sulmi, stervitja me e madhe ushtarake pertshin mjera zyrtarePerpara ndeshjes me Turqine: Nuk kemi presje](#)
fundit

Skenar lufte/ Lituania teston evakuimin e Vilniusit në rast sulmi, stërvitja më e madhe ushtarake përfshin mijëra zyrtarë



27 Shtator 2026, 20:00Bota TEMA



Lituania po zhvillon një nga skenarët më të mëdhenj të përgatitjes për një krizë të mundshme të sigurisë, duke testuar për herë të parë në nivel kombëtar një plan të detajuar për evakuimin e Vilniusit dhe zonave kufitare në rast të një kërcënimi ushtarak.

Stërvitjet, të koduara "Vyčio skliautas 2026", do të vijnë deri më 3 tetor dhe synojnë të testojnë reagimin e autoriteteve ndaj një përkeqësimit të ndjeshëm të situatës së sigurisë. Skenarët përfshijnë sulme kibernetike, ndërprerje të energjisë dhe komunikimeve, bllokimin e rrugëve të transportit, si dhe nevojën për prirjen dhe lëvizjen e forcave aleate.

Në stërvitje marrin pjesë 14 ministri, të 60 komunat e vendit, rreth 3 mijë zyrtarë dhe 1 mijë vullnetarë. Një prej objektivave kryesore është testimi i mënyrës se si do të organizohet evakuimi i civilëve në një situatë emergjente.

Lituania po bashkëpunon gjithashtu me Poloninë për hartimin e skenarëve që parashikojnë evakuimin e banorëve të vendeve baltike përtej kufirit polak në rast të një krize të madhe.

Në këtë planifikim një rëndësi të veçantë ka Korridori Suwalki, një korridor strategjik që lidh vendet baltike me pjesën tjetër të territorit të NATO-s përmes Polonisë. Ai konsiderohet i rëndësishëm si për lëvizjen e forcave dhe logjistikës ushtarake, ashtu edhe për transportin e civilëve në rast emergjence.

Pjesë e stërvitjes do të jetë edhe testimi i sistemeve të alarmit. Më 29 shtator, sirenat dhe sistemi kombëtar i njoftimit për emergjencat do të aktivizohen në të gjithë vendin për të verifikuar funksionimin e tyre.

Autoritetet lituaneze e paraqesin skenarin si një ushtrim përgatitor, por masat e ndërmarra janë të orientuara drejt situatave reale të krizës dhe synojnë të testojnë koordinimin e institucioneve dhe gatishmërinë e popullsisë.

Stërvitja zhvillohet në një klimë të tensionuar të sigurisë në rajon. Pak ditë më parë, në hapësirat propagandistike ruse qarkulloi një artikull me titullin "Rusia po përballet me një tjetër operacion ushtarak special. Do të jetë shumë i shkurtër", ku Lituania përmendej si një objektiv i mundshëm i një agresioni të ardhshëm

rus.

Megjithatë, nuk ka të dhëna në informacionin e mësipërm që një sulm ndaj Lituaniës është i afërt apo i planifikuar. Stërvitjet “Vyčio skliautas 2026” janë, në këtë fazë, një masë përgatitore për skenarë të ndryshëm të krizës.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

maon

19:20 Bota

Orteku godet ekspeditën në Himalaje, 10 alpinistë rezultojnë të zhdukur

18:40 Bota

Rusia lë të hapur transferimin e S-400 nga Turqia, Lavrov: Vendi marrës duhet të jetë mik i Moskës

17:20 Bota / 1 koment

Bitcoin mbi 84 mijë dollarë, pranë nivelit më të lartë në 8 muaj

17:10 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.